

DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË
STUDIO LIGJORE "CAKRANI"
Nr. License 8315
NUIS M 03525401 G



email; studiocakrani01@gmail.com
Nr. tel; 060 94 13 001
Adresa; L."I.Boletini"Blv;"I.Qemali" Vlorë
Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier

St. 25.8.2025

APELIM

APELUES: Ilir METAJ, i biri Rexhepit dhe Fiqiretes, dtl 24 mars 1969, lindur në Çepan, Skrapar, me adresë banimi Tiranë, Rr, "Vaso Pasha" Nd. 1817. H.0, Ap.005 ose pranë Partisë Lirisë, Sheshi Ujllson. Përfaqësuar me Akt-Përfaqësimi, të lëshuar më datë 22.05.2025 nga Studio Ligjore CAKRANI, me NUIS M03525401G av. Kujtim Cakrani me nr license 8315 regjistruar pranë Dhomës Avokatisë Fier. Email: studicakrani01@gmail.com nr.0699413001.

KUNDER: Vendimit nr. 546 datë 13.08.2025 të Gjykatës Shkallës Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar

BAZA LIGJORE: Nenet 248-249-422 i Kodit Procedurës Penale.

DREJTUAR: GJYKATES POSAÇME TE APELIT KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE OGRANIZUAR

E nderuara Gjykatë!

Me vendimin nr. 546 datë 13.08.2025 të Gjykatës Shkallës parë kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës së shtetasit Ilir Metaj, për zvendësimin e masës sigurimit personal nga "arresti në burg" parashikuar nga neni 238 i kodit procedurës penale, në masën e detyrimit për tu paraqitur pranë oficerit të policisë gjyqësore, ndalimi daljes jashtë vendit dhe garancinë pasurore.

Duke mos qënë dakord me vendimin e mësipërm vendosëm ta apelojmë pranë Gjykatës Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke parashtruar si më poshtë vijon:

Rrethanat e faktit:

1. Rezulton se; Në bazë të kallëzimit penal të shtetasit Romeo Kara, të cilin e ka depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, ku kallëzon shtetasit: Ilir Metaj, Sali Berisha, Kastriot Ismailaj, Tomas Pleskash dhe Bujar Nepravishta, për akte korruptive në lidhje me çështjen DIA- ÇEZ Shpërndarje, duke filluar nga lidhja e kontratës së parë me 1 shtator 2010 dhe vijim.


Në kallëzimin e tij shtetasi Romeo Kara ka shpjeguar se, gjatë angazhimit të tij si përfaqësues ligjor i OSHE në procedurën e arbitrazhit në Vjenë, është vënë në dijeni të informacioneve dhe procedurave, nga të cilat ka lindur dyshimi se mardhënia kontraktuale/tregtare midis kompanisë CEZ sha dhe kompanisë DIA, që në fillimet e saj është bazuar në afera korruptive.

Pas disa veprime hetimore, në kuadër të procedimit penal nr. 55 të vitit 2019, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar ka urdhëruar në datën 10.06.2024 si dhe ka kryer regjistrimin e njoftimit të veprave penale, përbri procedimit penal nr. 55, të vitit 2019 të emrit të shtetasit, Ilir Metaj, i dyshuar për veprën penale **“Korrupsionit pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurëve vendorë”**, e parashikuar nga neni 260 i kodit penal.

Në datën 10.06.2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar, ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. 122, për veprat penale **“Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”** e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, dhe **“Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”** parashikuar nga neni 190/3 i kodit penal.

2. Në datën 10.06.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar ka bërë regjistrimin e procedimit penal Nr. 122, për veprat penale, Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, e parashikuar nga neni 259 i KP dhe; Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve parashikuar nga neni 190/3 i KP. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimeve të shtetasve Halit Valteri, ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe shtetasit Idajet Beqiri, me profesion avokat, ndaj shtetasit Ilir Metaj, ish-president Republikës së Shqipërisë, ish-Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, ish-Ministër dhe ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Monika Kryemadhi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë, Vangjel Tavo, ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe ndaj shtetasit Iraklis T. Fidetzis, administrator i kompanisë Dorelita Limited. Në kallëzimin e tij, kallëzuesi Halit Valteri, pretendon se, nëpërmjet informacioneve të marra nga burime të hapura, sikurse është faqja Zyrtare e Internetit e FARA, një Organizëm në varësi të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, midis McKEON GROUP, një kompani që ushtron veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim si dhe kryetarit të saj Ilir Metaj, është lidhur një kontratë lobimi e cila financohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në shumën të konsiderueshme parash, të cilat jo vetëm janë fshehur pasi nuk janë deklaruar në organet kompetente sipas ligjit sikurse është dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, por origjina e tyre është produkt i veprës penale të Korrupsionit. Ndërkohë, vetë transferimi i fondeve në mënyrë të fshehtë duke përdorur ndërmjetësimin e Kompanisë Dorelita Limited, që në fazën e negociimit të marrëveshjes së nënshkruar, mund të bëjë që të jenë konsumuar elementet e figurës së veprës penale dhe pastrimi i produkteve të veprës penale si dhe veprimtarisë kriminale e parashikuar nga neni 287 i KP.

3. Në datën 23.06.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar ka bërë regjistrimin e procedimit penal Nr. 125, për veprat penale Korrupsioni



pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike e parashikuar nga neni 259 i KP dhe Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve, e parashikuar nga neni 190/3 i KP. Procedimi penal Nr. 125 është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të datës 23.06.2022, i bërë nga shtetasi Halit Valteri i cili ka kallëzuar shtetasit Ilir Metaj, Monika Kryemadhi, Petrit Vasili, Edmond Panariti, Elona Guri, Muharrem Berisha, Irsi Zajmi, Elena Gaçe, Jori Prifti dhe Agron Xhafa, se kanë konsumuar elemente të veprës penale; Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram parashikuar nga neni 257/a i KP; Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike e parashikuar nga neni 259 i KP; Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 287 i KP. Në kallëzimin në fjalë, kallëzuesi Halit Valteri pretendon se nëpërmjet informacioneve të marra nga burime të hapura, sikurse është faqja Zyrtare e Internetit e FARA, një Organizëm në varësi të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, midis Global Security and Innovative Strategies në vijim G.S.I.S, një kompani që ushtron veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe kryetarit të saj Ilir Metaj, është lidhur një kontratë lobimi e dates 03 Shkurt 2016, që financohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në shuma të konsiderueshme parash të cilat jo vetëm janë fshehur pasi nuk janë deklaruar në organet kompetente sipas ligjit sikurse është dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, por origjina e tyre është produkt i veprës penale korrupsion.

Ndërkohë vetë transferimi i fondeve në mënyrë të fshehtë mund të bëjë që të jenë konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i KP.

4. Në datën 04.06.2022, është bërë bashkimi i procedimeve Nr. 122/2022 dhe Nr. 125/2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në një procedim të vetëm me Nr. 122, të vitit 2022.

5. Në datën 15.09.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar procedimin penal Nr. 165, të vitit 2022. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Idajet Beqiri, i cili kallëzon shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi se kanë kryer veprat penale “Fshehja e të ardhurave” e parashikuar nga neni 180 i KP; Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendorë e parashikuar nga neni 245 i KP; Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja dhe deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram e parashikuar nga neni 257/a i KP; Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike e parashikuar nga neni 259 i KP si dhe Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale e parashikuar nga neni 287 i KP. Në kallëzimin e tij kallëzuesi pretendon se në vitet 2014-2022, çifti Metaj-Kryemadhi, kanë marrë shërbime mjekësore dhe shërbime të kirurgjisë estetike, me qëllim humbjen në peshë dhe ndryshimin e pamjes së tyre. Shërbime të tilla, sipas kallëzuesit, ndër të tjera, janë marrë në Klinikën Private Goldenes Kreuz Vjenë nga mjeku Gerhard Prager, në Klinikën Casa di Cura Privata Domus Medica në San Marino. Sipas kallëzuesit, jo vetëm që kostua e këtyre shërbimeve mjekësore është e lartë, çka nuk



justifikohet me të ardhurat e çiftit Metaj-Kryemadhi dhe, si rrjedhojë, nuk janë deklaruar në deklaratat vjetore të pasurisë të dorëzuara në Inspektoriatin e Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, por dhe burimet e financimit të tyre janë me shumica parash me origjinë korruptive. Veç kësaj, sipas kallëzuesit, këto lloj trajtimesh mjekësore, kërkojnë shpenzime të vazhdueshme, të cilat nuk mund të justifikohen me të ardhurat e çiftit.

6. Në vijim, nga ana e organit të akuzës është vendosur bashkimi i procedimit Nr. 165, datë 15.09.2022 me procedimin penal Nr. 122, datë 10.06.2022. Në datën 07.10.2024, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është urdhëruar regjistrimi në regjistrin e procedimeve penale të emrit të shtetasve: Ilir Metaj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë në 2 (dy) raste, nga të cilat po në dy raste është kryer në bashkëpunim, Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe Refuzimi për deklarim, Mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim të parashikuara nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 të KP.

7. Në datën 07.10.2024, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur bashkimin e procedimeve penale Nr. 55/2019 dhe Nr. 122/2022 në një procedim të vetëm duke e numërtuar atë me Nr. 55/2019.

8. Në fraksion të hetimit të gjithanshëm dhe objektiv të këtij procedimi penal, nga ana e organit të akuzës janë kryer veprimet hetimore përkatëse, për secilin nga faktet e pretenduara. Në analizë të rezultateve të përfuara nga këto hetime, organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se përse në hetim janë përfshirë dhe janë pjesëmarrës në kryerjen e një sërë veprash penale, kryesisht në veprat penale si “Korrupsioni pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendorë” “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” “Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara nga nenet 260, 287 dhe 257/a të KP, në disa raste në periudha të ndryshme kohore, si dhe në bashkëpunim midis tyre, në lidhje me faktet të cilat janë përshkruar gjerësisht në vendimarrjen e gjykatave.

9. Në këto kushte, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me kërkesën penale me objekt: Caktimin e masës së sigurimit personal (në mungesë pa pjesëmarrjen e personit të hetuar) ndaj personave në hetim: Ilir Metaj, Monika Kryemadhi, Piro Xhixho dhe Ema Çoku, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të pasqyruara në pjesën hyrëse.

10. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 125, datë 20.10.2024, ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



2. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg" e parashikuar nga neni 238 i KPP ndaj personit nën hetim **Ilir Metaj**, i biri i Rexhep dhe i Fiqirete, i datëlindjes 24.03.1969, lindur në Çepan, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë banimi: Rr."Vaso Pasha" Nd. 1817, H. 0, Ap. 005 ose pranë Partisë së Lirisë, Sheshi Uillson, me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, me gjëndje gjyqësore i padënuar, i dyshuar për kryerjen e veprave penale Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor në 3 (tre) raste, nga të cilat në dy raste është kryer në bashkëpunim, "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dhe "Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të KP.

Gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personi nën hetim Ilir Metaj, në sajë të pozicionit të tij zyrtar si ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë METE, ministri e cila ushtronte të drejtat dhe administronte aksionet e Shtetit Shqiptar pranë Shoqërisë ÇEZ Shpërndarje sh.a, nëpërmjet influencës së tij, ka arritur të ndërmjetësojë lidhjen e një kontrate midis ÇEZ shpërndarje dhe shoqërisë Debt Internacional Advisory me administrator në atë kohë shtetasin Kastriot Ismailaj, me qëllim që kjo e fundit ti afronte shërbime CEZ duke identifikuar debitorët dhe shumat monetare që ata i detyroheshin kompanisë. Personi nën hetim Ilir Metaj, e ka përdorur influencën e tij për të bërë të mundur lidhjen e kontratës me një shoqëri të drejtuar nga Kastriot Ismailaj pikërisht për shkak të lidhjeve të mëparshme që ai kishte me këtë person, dhe me qëllim ndërtimin në të ardhmen të një marrëdhënie korruptive.

Nga provat që i janë bashkëlidhur kërkesës dokumentohet se të paktën në një rast ai ka kërkuar dhe ka marrë nga shtetasi Kastriot Ismailaj shuma të konsiderueshme parash, duke krijuar te gjykata bindjen se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ka konsumuar në këtë mënyrë elementët e figurës së veprës penale të Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve e parashikuar nga neni 260 i KP. Për shkak të detyrës që personi nën hetim Ilir Metaj ka mbajtur, si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, por dhe si Kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, rezulton se ai ka ushtruar ndikimin e tij tek Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, personi nën hetim Piro Xhixho, i zgjedhur nga Kuvendi në kohën e drejtimit nga Ilir Metaj, me propozim të partisë të drejtuar nga Ilir Metaj, si dhe së bashku me bashkëshorten e tij, personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i Kompanisë së Telefonisë Celulare Vodafone, në mënyrë që të lidhej kontrata midis Vodafone dhe Unifi Communication Inc, administrator i të cilës ka qënë Adrian Shatku tranzitimin qëllimi e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/interkoneksionin.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, personi nën hetim Ilir Metaj në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi njëkohësisht dhe bashkëshorte e tij, kanë përfutur jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, por kanë përfutur një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes. Në këto kushte, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë



shtetërore dhe të zgjedhurve e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i KP. Personi nën hetim Ilir Metaj, në kohën që ka qenë Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e Minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Si rezultat i marrëdhënies së krijuar, Ilir Metaj dhe bashkëshortja e tij Monika Kryemadhi kanë pranuar propozimin e biznesmenit Samir Mane për të përfutur një vilë të ndërtuar në Kompleksin Rezidencial Rolling Hills. Pasi ky fakt është marrë vesh dhe nga persona të tjerë duke përfshirë dhe Ambasadorin Grek në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi duke mos e finalizuar marrëdhënien. Pavarësisht kësaj, ata e kanë pranuar premtimin. Si rrjedhojë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i KP.

Nëpërmjet blerjes së banesës së tij në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, Ilir Metaj ka përdorur si truk marrjen e kredive bankare, më pas shlyerja e kredive është bërë nga vjehrra e tij me shuma të konsiderueshme parash, të cilat as i ka patur dhe as ka patur mundësi ti siguronte. Në këtë mënyrë, është bërë futja në sistemin bankar dhe investimi në pasuri të paluajtshme e shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit. Në këtë mënyrë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim, bashkëshorten Monika Kryemadhi dhe vjehrrën e tij Fatime Kryemadhi, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 287/2 i KP. 10.2 Nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të lobimit, marrjes së shërbimeve nga këto kontrata, dhe financimit me shuma të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga llogari të padeklaruara prej tij, si dhe mosdeklarimi i shpenzimeve sipas ligjit në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në këtë mënyrë më shumë se një herë, e parashikuar nga neni 287/2 i KP, në dy rrethana cilësuese të kryerjes së saj, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë. Nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht deklaratën e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në LL.D.K.P.K.I në vitin 2020, sipas ligjit Nr. 9049 datë 10 Prill 2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve" i ndryshuar, ndërkohë që dyshohet se ka qenë në pamundësi për ti siguruar këto shuma parash nëpërmjet burimeve të ligjshme, por dhe dyshimi për përfshirje në veprimtari kriminale të korrupsionit, pra paligjshmëria e burimeve, personi nën hetim Ilir Metaj dyshohet se gjatë plotësimit të deklaratave vjetore të pasurisë dhe më konkretisht periodikun e vitit 2019 dhe dorëzimin e saj në LL.D.K.P.K.I në vitin 2020, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Refuzimit për deklarin; Mosdeklarimit; Deklarimit të rremë të pasurive; Interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike, ose i çdo personi që ka detyrimin për deklarin", e kryer kjo kryesisht në formën e deklarin të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme parashikuar nga neni 257/a



paragrafi i dytë i KP. Po kështu, mbi të dhënat dhe deklaratimet e sipërcituara, që i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë, mbështetet edhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim Monika Kryemadhi, ka konsumuar elementët e figurave të veprave të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve” e kryer në bashkëpunim dhe 2 (dy) herë, parashikuar nga neni 260 e 25 të i KP; “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/2 i KP dhe “Refuzimit për deklaram, mosdeklarimit, deklarimit të rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike, ose i çdo personi që ka detyrimin për deklaram e kryer në formën e deklarimit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i KP. Në saj të detyrës që personi nën hetim Monika Kryemadhi ka mbajtur, si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, por dhe bashkëshortja e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, ka ushtruar ndikimin e saj tek Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, personi nën hetim Piro Xhixho i zgjedhur nga Kuvendi me propozim të partisë ku ajo aderon dhe ku ka qënë kryetare, si dhe së bashku me bashkëshortin e saj personin tjetër nën hetim Ilir Metaj kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i Kompanisë të Telefonisë Celulare Vodafone, në mënyrë që të lidhej kontrata midis Vodafone dhe Unifi Communication Inc, administrator i të cilës ka qënë Adrian Shatku, me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/ interkoneksionin.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, personi nën hetim Monika Kryemadhi në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim Ilir Metaj njëkohësisht dhe bashkëshort i saj, kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, por kanë përfituar një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se në këtë mënyrë kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 260 e 25 i KP.

10.3 Personi nën hetim Monika Kryemadhi, në kohën kur ka qënë Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, personin nën hetim Ilir Metaj, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e Minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Si rezultat i marrëdhënies së krijuar, Monika Kryemadhi dhe bashkëshorti i saj Ilir Metaj, kanë pranuar propozimin e biznesmenit Samir Mane për të përfituar një vilë të ndërtuar në Kompleksin Rezidencial Rolling Hills. Pasi ky fakt është marrë vesh dhe nga persona të tjerë duke përfshirë dhe Ambasadorin Grek në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi duke mos e finalizuar marrëdhënien. Pavarësisht kësaj, ata kanë pranuar premtimin dhe si rrjedhojë krijohet dyshimi i arsyeshëm se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 260 e 25 i KP. Nëpërmjet blerjes së banesës së saj në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, personin nën hetim Ilir Metaj, Monika Kryemadhi ka përdorur si truk marrjen e kredive bankare, më pas shlyerja e kredive është bërë nga nëna e saj me shuma të konsiderueshme parash, të cilat rezultojnë se nuk i ka patur dhe as ka patur mundësi që ti siguronte. Në këtë mënyrë, është bërë futja në sistemin bankar, dhe investimi në pasuri të paluajtshme e shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit.



Në këtë mënyrë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Monika Kryemadhi në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim bashkëshortin e saj Ilir Metaj dhe nënën e saj Fatime Kryemadhi, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/2 i KP. Nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht deklaraten e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në LL.D.K.P.K.I në vitin 2020, sipas ligjit Nr. 9049 datë 10 Prill 2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve” i ndryshuar.

E nderuara Gjykatë!

Në datën 04 gusht 2025 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit vendosi përfundimin e hetimeve për ish Presidentin Republikës z. Ilir Metaj, ku u njohëm me përfundimin e hetimeve, bashkë me aktet sipas nenit 327/3-4 të Kodit Procedurës Penale, dhe në vijim vendosëm ti drejtohem Gjykatës Shkallës Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar me kërkesën për zvendësimin e masës sigurimit personal bazuar kjo në nenin 260/2 të kodit procedurës penale.

Kërkesa drejtuar gjykatës u bë kur ishim përpara një realiteti dhe në moment procedural krejt të ri përsa i përket gjendjes së procedimit, provave dhe çdo rrethane juridike. Në kushtet e reja procedurale nuk qëndronte më mendimi që buron nga neni 228 paragrafi 3 i kodit procedurës penale, për masat e sigurimit personal:


a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti.....

b) nuk ka asnjë rrezik që i pandehuri të largohet dhe ti fshihet procesit gjyqësor.

c) personaliteti të Pandehurit nuk përbën rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, sepse nuk është duke ushtruar funksionin publik.

Në kuptim të rrethanave të reja të krijuara kur kjo çështje tashmë po merr rrugëtimin e saj gjyqësor, mendojmë se është një moment kur vetë gjykata që ka vendosur masën shtrënguese të “arrestit me burg” të analizojë drejt këto rrethana dhe të marri një vendim të bazuar mbi to duke zvendësuar masën e sigurimit personal.

Gjithashtu si përfaqësues ligjorë i jemi drejtuar gjykatës për zvendësimin e masës sigurimit të arrestit me burg për ish presidentin z. Ilir Metaj, pasi ai ka mbi 10 muaj në kushte izolimi, pra në paraburgim, dhe çështja nuk ka shkuar ende në gjykatë për të nisur procesin gjyqësor në themel, çka përbën një tjetër shkelje të rëndë jo vetëm të Kodit Procedural Penal, Kushtetutës Shqipërisë por edhe Kartës Europiane të Drejtave të Njeriut, dhe padyshim të disa vendimeve të Gjykatës Europiane që paraburgimin e gjatë e kanë cilësuar si një masë repressive, diskriminuese dhe cënimin e rëndë të prezumimit pafajësisë. Gjithashtu kërkesa për zvendësim të masës sigurimit kishte në një nga pikat e saj edhe shqetësimin mbi trajtimin diskriminues deri në hakmarrje politike ndaj ish Presidentit z. Ilir Metaj lidhur me mënyrën e qasjen jashtë çdo standarti demokratik të Institucionit Ekzekutimit Vendimeve



penale "Jordan Misja" Tiranë, pasi është në kushtet e një izolimi total, ku si shembull të një trajtimi të tillë politik barazohet vetëm me ish liderin e opozitës Ruse, Navalny.

Në kërkesën tonë drejtuar Gjykatës Shkallës Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar, kërkuam zvendësimin e masës së sigurimit personal edhe për shkaqet të tjera padyshim më të rëndësishme se një ndryshim të statusit procedural, kërkuam që të merret parasysh nga gjykata edhe pozicioni tij politik si President i Partisë Lirisë, i një partie opozitare, e dyta për nga rëndësia në jo vetëm si opozitë por edhe si parti parlamentare. Atij nuk po i lejohet të takohet me anëtarët e kryesisë partisë tij, me deputetët, me eurodeputetët dhe është privuar nga përdorimi telefonit të institucionit për të folur me sekretariatën e partisë, deputetët dhe mbi të gjitha me mediat dhe gazetarët.

Është në detyrimin ligjor, Kushtetues por dhe të Kartës Europiane të Drejtave të Njeriut ku ndaj një politikani nën hetim, apo nën gjykim duhet të trajtohet jo vetëm me dinjitetin njerëzor të parashikuar në standartet më të mira që parashikon ligji por, ti krijohen kushtet, lehtësirat dhe të mos i privohet ushtrimi të drejtave politike, komunikimi me sekretariatën e partisë, mediat dhe gazetarët, dhe mbi të gjitha duhet të merret parasysh instituti i prezumimit të pafajësisë.

E nderuara gjykatë!

Për të kërkuar zvendësimin e masave të sigurimit personal ligjvënësi ka parashikuar disa kriteret dhe ndër to është edhe ndryshimi kushteve, atëherë kur nevojat e sigurimit zbuten dhe kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit.....

Gjykata e shkallës parë nuk ka marrë parasysh këtë dispozitë dhe paragrafin 2 të nenit 260 të kodit penal por ka pranuar vetëm kërkuesin e organit të akuzës që ishte vetëm një fjalë;...Kërkesa e avokatit të rrëzohet për faktin se, i pandehuri ish presidenti Ilir Metaj përbën rrezik për dëmtimin e provave dhe saktësisht atyre me dëshmitarë!

Po çfarë thotë analiza juridike e Gjykatës Shkallës Parë për rrëzimin e kërkesës për zvendësimin e masës;

Në përfundim të gjykimit të kësaj çështje, në sajë të provave që ju nënshtroan gjykimit, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk evidentohet të jemi para asnjërit prej rasteve të parashikuara në ligj kur gjykata mund të disponojë me zëvendësimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" me një masë tjetër sigurimi më të butë. Më konkretisht, gjykata vlerëson se:

Së pari, nuk jemi përpara rastit kur masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Gjatë gjykimit nuk u evidentuan rrethana të reja, të krijuara më pas e që lidhen me veprën penale për të cilën është caktuar masa e sigurimit, rrethana të cilat do ta çonin gjykatën në konkluzionin se masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Përkundrazi, gjatë gjykimit rezultoi e provuar se organi i akuzës (Prokuroria e Posaçme) me vendimin dt. 26.05.2025 "Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës" bazuar në nenin 34 të K.Pr. Penale ka vendosur:



1. Të marrë në cilësinë e të pandehurit, personin nën hetim Ilir Metaj akuzuar për kryerjen e figurave të veprave penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë" në 3 (tre) raste nga të cilat në 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim, "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim" të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të K.Penal. Sa më sipër, konstatohet se në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi, në krahasim me momentin e caktimit/zbatimit të masës së sigurimit personal "arrest në burg" pozita procedurale e kërkuesit është më e rënduar kjo pasi në sajë të provave që janë mbledhur gjatë hetimeve ai tashmë ka marrë cilësinë e të pandehurit duke iu komunikuar zyrtarisht dhe akuza në ngarkim të tij. Pra, në rastin konkret, për sa i përket akuzës, në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi kemi një konsolidim të saj.

Në këto kushte, gjykata vlerëson se edhe në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi masa e sigurimit personal "arrest në burg" e caktuar ndaj të pandehurit Ilir Metaj, vazhdon që të jetë proporcionale në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprat penale konkrete për të cilat ai akuzohet (neni 229 i KPP).

Së dyti, gjykata vlerëson se nuk jemi para rastit kur nevojat e sigurimit janë zbutur. Nga ana e kërkuesit (të pandehurit) Ilir Metaj dhe mbrojtësve të tij gjatë gjykimit u pretendua se nevojat e sigurimit janë zbutur pasi organi i akuzës i ka përfunduar hetimet duke i mbledhur të gjitha provat e çmuara të nevojshme për gjykimin e kësaj çështje penale dhe në këto kushte nuk ekziton më rreziku për të ndikuar në marrjen dhe vërtetësinë e provave.

Prokuroria e kundërshtoi këtë pretendim duke theksuar se në rastin konkret nuk ka zbutje të nevojave të sigurimit për sa kohë është konsoliduar akuza dhe kërkuesi ka marrë cilësinë e të pandehurit duke ju atribuar dhe akuzat përkatëse. Gjithashtu, sipas organit të akuzës vlerësohet se rreziku për marrjen e provës vijon që të jetë ekzistent, kjo pasi gjatë gjykimit do të kërkohet që të pyeten si dëshmitare një sërë personash që bëjnë pjesë në subjektin politik ku i pandehuri është president. Në këto kushte organi i akuzës vlerëson se ekziston përsëri rreziku që i pandehuri të influencojë apo ndikojë në marrjes e provës në rastin konkret në mënyrë që këta shtetas të bëjnë deklarime në favor të pozitës së tij në raport me procedimin.

Në lidhje me këtë pretendim, gjykata konstaton se organi i akuzës (Prokuroria e Posaçme) në bazë të nenit 327 të K.Pr.Penale me datën 28.07.2025 me aktin "Njoftim për përfundimin e hetimeve" i ka njoftuar të pandehurit Ilir Metaj përfundimin e hetimeve të procedimit penal (në njoftim ka nënshkruar personalisht i pandehuri Ilir Metaj dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij, av. Kujtim Cakrani). Në zbatim të nenit 327/4 të K.Pr. Penale organi i akuzës e ka njoftuar të pandehurin se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje.



Gjithashtu, gjykata konstaton se masa e sigurimit personal "arrest në burg është caktuar ndaj të pandehurit Ilir Metaj duke e përligjur me ekzistencën ndër të tjera edhe të kushtit që lidhet me rrezikun e "helmimit të provës" sipas parashikimit të pikës 3, shkronja "a" të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykatat kanë vlerësuar se në rastin konkret evidentohet prania e rrethanave nga të cilat krijohet vlerësimi se ka rrezik eminent që liria e pakushtëzuar me masë sigurimi e kërkuar (të pandehurit) Ilir Metaj mundet të helmojë provat apo mundet të riskojë gjetjen dhe fiksimin e gjendjes natyrore të tyre. Në vlerësimin e rrezikut sipas parashikimit të shkronjës "a" të pikës 3 të nenit 228 të K.Pr. Penale, gjykata ka mbajtur në vëmendje faktin që shtetasi Ilir Metaj për shkak të funksionit që ka aktualisht apo funksioneve që ka pasur në të kaluarën, mund të ushtrojë influencën e tij për të ndikuar në procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provave të tjera, të ndryshme nga ato dokumentare, sikurse janë pyetja e personave që kanë dijeni për faktet objekt hetimi, duke qënë se ai po hetohet për disa vepra penale. Në këtë mënyrë, pushteti dhe lidhjet që i pandehuri ka krijuar për shkak të funksioneve që ai ka aktualisht, ka pasur apo pozitës së tij në shoqëri krijon mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar tek dëshmitarët potencialë të faktit penal dhe gjithashtu edhe tek subjekte të tjerë publikë, me qëllim "helmimin e provës", për të lehtësuar pozitën e tij në raport me procedimin.

Edhe në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi referuar pohimit që palët bënë gjatë gjykimit, konstatohet se procedimi penal nr. 122/2022 i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar, Shiko vendimet nr. 59 (87-2024-333), dt. 19.11.2024 dhe nr. 165 (87-2025-253) datë 17.07.2025 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vijon që të jetë ende në fazën e hetimit paraprak pasi nuk rezulton që të jetë paraqitur kërkesa "për dërgimin e çështjes në gjyq", megjithëse organi i akuzës i ka njoftuar të pandehurit përfundimin e hetimeve. Në këto kushte, nga krahasimi i nevojave të sigurimit dhe rëndësisë së faktit në momentin që është marrë kjo masë sigurimi me gjendjen aktuale në të cilën pasqyrohen faktet dhe rrethanat në momentin procedural që po kërkohet zëvendësimi i saj, nuk rezulton që të evidentohen rrethana të reja që lidhen me personin nën hetim, të krijuara pas dhënies së vendimit për caktimin e masës së sigurimit personal, të cilat të jenë të tilla që të kenë zbutur nevojat e sigurimit apo rrethanat e faktit lidhur me të.

Gjykata vlerëson se fakti që në rastin konkret organi i akuzës i ka komunikuar të pandehurit aktin procedural të njoftimit të përfundimit të hetimeve, nuk i ka zbutur nevojat e sigurimit duke e eliminuar rrezikun e marrjes dhe vërtetësisë së provave. Sipas sistemit tonë procedural penal me natyrë akuzatore, provat formohen gjatë debatit gjyqësor, pra të gjitha të dhënat e grumbulluara nga ana e organit të akuzës në fazën së hetimeve paraprake e marrin vlerën e tyre në gjykim. Është e vërtetë që njoftimet mbi faktet dhe rrethanat mbi të cilat prokurori do të mbështesë akuzën fiksohen gjatë hetimeve por vlerën e provës ato e marrin gjatë fazës së gjykimit. Në këtë drejtim, përfundimi i fazës së hetimeve paraprake nuk e zbeh rrezikun e dëmtimit të provave. Më e ndjeshme kjo bëhet kur jemi përpara provave të gjalla, të cilat janë të tilla që jo vetëm formësohen ekskluzivisht gjatë shqyrtimit gjyqësor por kanë natyrë të paqëndrueshme lidhur me faktet dhe rrethanat që i prezantojnë procesit gjyqësor. Këto prova, me kalimin e një kohe të gjatë nga momenti i ndodhjes së



faktit ose rrethanës, ose nën ndikimin e faktorëve të brendshëm e të jashtëm, kanë tendencë të humbasin aftësinë për ta riprodhuar të dhënë sikurse ajo është perceptuar. Ndryshe nga ato, provat e ngrira, nuk ndryshojnë me kalimin e kohës dhe nën trysinë e faktorëve të ndryshëm. Gjithsesi, edhe këtu duhet të mbahet në konsideratë që mënyra e marrjes së një prove të tillë mund të konstatohet si në shkelje të ligjit dhe si e tillë prova të deklarohet e papërdorshme, çka do të sillte nevojën e marrjes së rishmimi të saj.

Në këtë kuadër, gjykata vlerëson se, nëse mund të pranohet që rreziku i marrjes së provave ulet me administrimin e provave të ngrira nga organi procedues gjatë fazës së hetimeve paraprake, kjo nuk mund të thuhet për provat e gjalla. Dëshmitarët dhe të bashkëpandehurit ose edhe ekspertët nëse lind nevoja e pyetjes së tyre, do të duhet të riprodhojnë atë çfarë kanë perceptuar përpara gjykatës si dhe t'i përgjigjen pyetjeve të kësaj të fundit dhe palëve. Përjashtim bëhet vetëm në rastin kur i pandehuri kërkon gjykim të shkurtuar dhe gjykata e pranon, duke marrë vlerë deklarimi i dhënë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Një fakt i tillë nuk rezulton që të ketë ndodhur në rastin konkret pasi çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve paraprake. Në këtë drejtim, provat e gjalla janë gjithnjë të kërcënuara nga ndikimi që i pandehuri mund të ushtrojë mbi to.

Organi i akuzës (Prokuroria e Posaçme) i bëri me dije gjykatës se gjatë hetimeve që janë zhvilluar në kuadër të procedimit penal nr. 122/2022 është pyetur një numër i konsiderueshëm shtetasish të cilët kanë dijeni mbi faktet penale objekt hetimii. Një pjesë e tyre kanë qënë dhe vijojnë që të jenë edhe aktualisht anëtarë apo gëzojnë funksione në subjektin politik në të cilin i pandehuri aktualisht është president. Prokurori bëri me dije për gjykatën se të gjithë këta shtetas do të kërkohen nga organi i akuzës që të pyetën në gjykim me cilësinë e dëshmitarit duke u konsideruar si prova të gjalla.

Në këto kushte, gjykata vlerëson se ekziston përsëri rreziku që shtetasi Ilir Metaj për shkak të funksionit që ka aktualisht apo funksioneve që ka pasur në të kaluarën, mund të ushtrojë influencën e tij për të ndikuar në procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provave të tjera, të ndryshme nga ato dokumentare, sikurse janë pyetja e personave që kanë dijeni për faktet objekt hetimi, duke qënë se ai po hetohet për disa vepra penale. Në këtë mënyrë, pushteti dhe lidhjet që i pandehuri ka krijuar për shkak të funksioneve që ai ka aktualisht apo ka pasur apo pozitës së tij në shoqëri krijon mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar tek dëshmitarët dhe gjithashtu edhe tek subjekte të tjerë me qëllim "helmimin e provës", për të lehtësuar pozitën e tij në raport me procedimin.

E nderuara Gjykatë!

Mendojmë se analiza dhe arsyetimi gjykatës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës është bazuar vetëm në dy momente por në fakt ato janë një e vetme:

Në pikën e parë kur thotë se: Nuk jemi përpara rastit kur masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Gjatë gjykimit nuk u evidentuan rrethana të reja, të krijuara më pas e që lidhen me veprën penale për të cilën është caktuar masa e sigurimit, rrethana të cilat do ta çonin gjykatën në konkluzionin se masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të



çaktohet. Përkundrazi, gjatë gjykimit rezultoi e provuar se organi i akuzës (Prokuroria e Posaçme) me vendimin dt. 26.05.2025 "Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës" bazuar në nenin 34 të K.Pr. Penale ka vendosur:

Të marrë në cilësinë e të pandehurit, personin nën hetim Ilir Metaj akuzuar për kryerjen e figurave të veprave penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë" në 3 (tre) raste nga të cilat në 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim, "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram" të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të K.Penal. Sa më sipër, konstatohet se në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi, në krahasim me momentin e caktimit/zbatimit të masës së sigurimit personal "arrest në burg" pozita procedurale e kërkuesit është më e rënduar kjo pasi në sajë të provave që janë mbledhur gjatë hetimeve ai tashmë ka marrë cilësinë e të pandehurit duke iu komunikuar zyrtarisht dhe akuza në ngarkim të tij. Pra, në rastin konkret, për sa i përket akuzës, në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi kemi një konsolidim të saj.

Në këto kushte, gjykata vlerëson se edhe në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi masa e sigurimit personal "arrest në burg" e caktuar ndaj të pandehurit Ilir Metaj, vazhdon që të jetë proporcionale në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprat penale konkrete për të cilat ai akuzohet (neni 229 i KPP).

1-Kundërshtimi dhe vlerësimi mbrojtjes: Padyshim që ky është një arsyetim që nuk i përgjigjet rrethanave të reja procedurale të krijuara pas datën 04 Gusht 2025 kur hetimet përfunduan dhe çështja tani do i kalojë gjykatës, ku aty do të kemi përballjen e radhës mbi hetimet, një procedurë kjo hetimore që ligjvënësi e ka inkorporuar në ligjin procedural penal në vitin 2017 me qëllim që gjyqtari kësaj seance që quhet paraprake të dëgjojë pretendimet e palëve lidhur me hetimet nëse ato janë të plota, brenda standarteve që parashikon ligji procedural penal dhe vendos nëse do ti kthej aktet përsëri organit akuzës për të vazhduar hetimet ose do ja kaloj për gjykim në themel.

E solla në vëmendjen e gjykatës këtë moment, për të kundërshtuar arsyetimin e gjyqtarit të shkallës parë për sa i përket faktit të ndryshimit procedural që ka pësuar çështja në ngarkim të ish presidentit të Shqipërisë z. Ilir Metaj.

Gjyqtari në vendimin e tij ka krijuar një precedent shumë të rrezikshëm, duke analizuar se prokuroria e akuzon ish presidentin për tre vepra të "rënda" penale çka nënkupton se ai paragjykon çështjen duke harruar se ai është duke shqyrtuar kërkesën për zvendësim mase dhe jo themelin e saj për të vërtetuar nëse akuzat qëndrojnë apo jo dhe se ato janë të rënda! Gjyqtari në vendimin e tij ka dalë jashtë objektit të kërkesës, dhe ai në qëndrimin tona ka cënuar rëndë institucionin e prezumimit të pafajësisë. Komunikimi akuzës dhe përfundimi hetimeve sipas arsyetimit të gjyqtarit nuk përbën ndryshim procedural, por një vendim fajësie për të pandehurin! Kjo analizë e tij është tejte e papërgjegjshme sepse ai jo vetëm



që ka paragjykuar të pandehurin duke marrë të mirëqëna çdo kërkesë të organit të akuzës (afërmendësh gjykata vendos çfarë kërkon prokuroria) por ka dhënë edhe fajësinë ndaj tij mbi akuzat që rëndojnë. Gjykata e Shkallës Parë me këtë vendim ka dalë jo vetëm jashtë objektit të kërkesës, por ka dalë edhe jashtë rolit saj. Gjyqtari hetimeve paraprake nuk e ka në detyrimin procedural për të dhënë mendim fajësie apo pafajësie, se për këtë procedura legjitimon gjyqtarët e themelit, pasi gjyqtari hetimit paraprak është aty vetëm për të dëgjuar palët, prokurorin, avokatin dhe për të analizuar dhe vlerësuar veprimet e tyre hetimore vetëm për këtë fazë.

Rreziku marrjes së provave që analizon gjykata në vendimin e saj, është më shumë një alibi se një arsyetim korrekt! Me përfundimin e hetimeve dhe njohjen e të pandehurit me aktet është momenti procedural ku pasi përfundimisht prokuroria i ka përfunduar hetimet, marrjen e provave, si me dëshmitarë edhe ato shkresore. Me përfundimin e hetimeve "helmimi provave" nga i pandehuri është i pamundur.

Arsyetimi i gjykatës se i pandehuri përbën rrezik për prishjen e provave të gjalla, që nënkupton intimidimin e dëshmitarëve, është lajthitje nëse nuk do jetë dashakeqësi në analizën e gjykatës, sepse provat e gjalla, pra dëshmitarët i kanë dhënë dëshmitë të tyre dhe ato janë të pasqyruara në vendimin e përfundimit të hetimeve, ku do jenë edhe në kërkesën e organit të akuzës që do i kërkojë gjykatës për kalimin e çështjes në gjykim. Po, nëse organi i akuzës i ka dëshmitarët të paqëndrueshëm psikologjikisht, apo ka intimiduar dhe shantazhuar për të dëshmuar në ato që i interesojnë organit të akuzës, ky është një problem i madh jo vetëm për integritetin e dëshmitarëve por edhe për çështjen në tërësi.

Gjykata në analizën e saj thotë se: Dëshmitarët duhet të dëshmojnë edhe përpara gjykatës atë që kanë dëshmuar në prokurori! Çfarë mund ti duhet gjyqtarit të hetimeve paraprake si do dëshmojnë apo jo dëshmitarët në seancën gjyqësore të themelit? Ai është problem i dëshmitarit nese bie ndesh me çfarë kanë dëshmuar më pare, kodi penal ka parashikuar edhe dëshminë e rremë. E pra edhe kjo analizë që s'është e logjikhme juridikisht nuk mund të qëndrojë si pretendim për të rrëzuar kërkesën për zvendësim masës sigurimit personal..

Arsyetimi gjykatës si alibi e prishjes provave të gjalla (provat me dëshmitarë) është e pabazuar, dhe në këtë kuptim gjykata përsëri e ka paragjykuar çështjen! Nga mund ta dijë gjyqyari hetimeve paraprake si do shkoj çështja, ndërkohë që kemi përpara seancën paraprake?! Madje aty do filtrohen provat nëse janë marrë dhe administruar në përputhje me dispozitat procedurale. Pra Gjyqtari ka analizuar me sentiment e zemër dhe jo me një logjikë e mendim juridik të iluminuar paanëshëm dhe të pavarur.

Dhe për të rrëzuar pretendimin tjetër të gjyqtarit, se nuk kanë ndryshuar kushtet dhe se janë ato që kanë qënë që në momentin e parë të masës sigurimit personal arrest në burg, kjo nuk qëndron! Sepse në atë gjykim, pra në datën 23 Tetor 2024 organi akuzës justifikonte arrestimin dhe vazhdimin e masës shtrënguese të sigurimit personal, edhe me faktin e një lobimi ndërmjet shtetasit Iraklis T. Fidetzis, administrator i kompanisë Dorelita Limited dhe kompanisë McKEON GROUP, e cila ishte edhe akuza me të cilën "krenohej" organi prokurorisë sepse sipas saj ishin paguar shuma të mëdha për foto me eksponentë të lartë



politikës në SHBA në favor të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim etj. Kjo akuzë me kalimin e kohës pasi u vërtetua me pretendimet e personit nën hetim z. Ilir Metaj se nuk ekzistonte, ra.

Këtë fakt organi akuzës nuk e njeh dhe vlerëson si zbutje të rrethanave të faktit rënien e një akuze me të cilën kërkoi gjykatës në datën 21 Tetor masën e sigurimit personal të arrestit në burg! Gjithsesi gjykata në analizën e saj ka pranuar pretendimet prokurorisë edhe pse kjo e fundit nuk mundi ti provojë gjykatës si dhe çfarë mundësie ka në këto rrethana Presidenti Partisë Lirisë z. Ilir Metaj të kërkcënojë apo zhantazhoi dëshmitarët, ndërkohë që dëshmitë e tyre janë të administruara dhe do kalojnë në gjykim themeli.

Së dyti, gjykata vlerëson se nuk jemi para rastit kur nevojat e sigurimit janë zbutur. Nga ana e kërkuesit (të pandehurit) Ilir Metaj dhe mbrojtësve të tij gjatë gjykimit u pretendua se nevojat e sigurimit janë zbutur pasi organi i akuzës i ka përfunduar hetimet duke i mbledhur të gjitha provat e çmuara të nevojshme për gjykimin e kësaj çështje penale dhe në këto kushte nuk ekziston më rreziku për të ndikuar në marrjen dhe vërtetësinë e provave.

Prokuroria e kundërshtoi këtë pretendim duke theksuar se në rastin konkret nuk ka zbutje të nevojave të sigurimit për sa kohë është konsoliduar akuza dhe kërkuesi ka marrë cilësinë e të pandehurit duke ju atribuar dhe akuzat përkatëse. Gjithashtu, sipas organit të akuzës vlerësohet se rreziku për marrjen e provës vijon që të jetë ekzistent kjo pasi gjatë gjykimit do të kërkohet që të pyeten si dëshmitarë një sërë personash që bëjnë pjesë në subjektin politik ku i pandehuri është president. Në këto kushte organi i akuzës vlerëson se ekziston përsëri rreziku që i pandehuri të influencojë ndikojë në marrjes e provës në rastin konkret në mënyrë që këta shtetas të bëjnë deklaratime në favor të pozitës së tij në raport me procedimin.

Në lidhje me këtë pretendim, gjykata konstaton se organi i akuzës (Prokuroria e Posaçme) në bazë të nenit 327 të K.Pr.Penale më datën 28.07.2025 me aktin "Njoftim për përfundimin e hetimeve" i ka njoftuar të pandehurit Ilir Metaj përfundimin e hetimeve të procedimit penal (në njoftim ka nënshkruar personalisht i pandehuri Ilir Metaj dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij, av. Kujtim Cakrani). Në zbatim të nenit 327/4 të K.Pr. Penale organi i akuzës ë ka njoftuar të pandehurin se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklaratime apo të kërkojë që të merret në pyetje.

Gjithashtu, gjykata konstaton se masa e sigurimit personal "arrest në burg është caktuar ndaj të pandehurit Ilir Metaj duke e përligjur me ekzistencën ndër të tjera edhe të kushtit që lidhet me rrezikun e "helmimit të provës" sipas parashikimit të pikës 3, shkronja "a" të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Gjikata ka vlerësuar se në rastin konkret evidentohet prania e rrethanave nga të cilat krijohet vlerësimi se ka rrezik eminent që liria e pakushtëzuar me masë siguri e kërkuesit (të pandehurit) Ilir Metaj mundet të helmojë provat apo mundet të riskojë gjetjen dhe fiksimin e gjendjes natyrore të tyre. Në vlerësimin e rrezikut sipas parashikimit të shkronjës "a" të pikës 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale, gjykata ka mbajtur në vëmendje faktin që shtetasi Ilir Metaj për shkak të funksionit që ka aktualisht



apo funksioneve që ka pasur në të kaluarën, mund të ushtrojë influencën e tij për të ndikuar në procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provave të tjera, të ndryshme nga ato dokumentare, sikurse janë pyetja e personave që kanë dijeni për faktet objekt hetimi, duke qënë se ai po hetohet për disa vepra penale. Në këtë mënyrë, pushteti dhe lidhjet që i pandehuri ka krijuar për shkak të funksioneve që ai ka aktualisht, ka pasur apo pozitës së tij në shoqëri krijon mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar tek dëshmitarët potencialë të faktit penal dhe gjithashtu edhe tek subjekte të tjerë publikë, me qëllim "helmimin e provës", për të lehtësuar pozitën e tij në raport me procedimin.

2-Arsyetimi kundërshtues i mbrojtjes: Në vijim të arsyetimit të bërë nga Gjykata e Shkallës Parë, se nuk ka zbutje të nevojave të sigurimit, është e një arsyetim që nuk qëndron! Zbutja e nevojave nuk kërkon domosdoshmërisht rënien e akuzave, jo! Ajo parashikon edhe ndryshimin e statusit procedural, pasi kërkesa për zvendësim mase është bërë pikërisht pasi hetimet kanë përfunduar dhe ska më asnjë mundësi objektive për të helmuar provat. Pretendimin për vazhdimin e masës sigurimit personal të arrestit në burg, ndaj ish presidentit z. Ilir Metaj, me arsyetimin se ai po të jetë në një masë tjetër sigurimi mund të helmojë provat e gjalla, pra dëshmitarët, e ngriti organi akuzës gjatë parashtrimeve të tij, por ai nuk specifikoi cilët dëshmitarë mund të intimidojë dhe përse duhet ta bëjë këtë?

Gjykata në këtë rast duhet ti kërkonte organit procedurës rast konkret, apo shfaqe të mëparëshme të ndonjë veprimi të tillë. Pretendimi se i pandehuri është një person influent dhe kryetar duke akuzuar fare hapur se mund të sajojë prova dokumentare nuk është arsyetim ligjor nga gjykata, por një paragjykim me nuancë akuze e gjyqtarit ndaj tij. Kjo qasje nuk përbën gjë veçse shfaqje një opinioni të brendshëm për ish presidentin z. Ilir Metaj. Me këtë arsyetim gjyqtari është vet dekonspiruar si një gjyqtar që vetëm i paanshëm dhe objektiv nuk mund të jetë, por si edhe ndodhi u kthye në një gjyqtar paragjykues. Se nga buron ky paragjykim i hapur deri mund të themi një lloj urrejtje personale, mendojmë se këtë shpjegim që vetëm gjyqtari mund ta japë. Si është e mundur të arsyetosh një vendim me një rëndësi kaq të madhe kur diskutohet masa ekstreme arrestit në burg, dhe të pranosh si argument në frymë dhe gërmë çdo pretendim të organit akuzës, ndërkohë që organi akuzës nuk ju jep asnjë indicje lidhur me pretendimet e tij për kërcënim të dëshmitarëve! Psh tek cilët dëshmitarë dyshon organi akuzës që i pandehuri z. Ilir Metaj do mund të marrë mundimin për ta shantazhuar? Gjejmë me vend të sqarojme këtu se, shumica e tyre nuk janë më pjesë e organizatës Partisë së Lirisë ashtu siç edhe pretendon gjyqtari në arsyetimin e tij. Shumica e personave që janë pyetur nga organi procedurës si dëshmitarë prej shumë kohësh janë larguar prej kësaj partie dhe kanë gjetur strehë tek partia në pushtet që kontrollon gjithë institucionet dhe të gjithë, dikush është zgjedhur kryetar bashkie nën siglën e Partisë Socialiste, dikush kandidat për deputet te Partia Socialiste, dikush në administratën publike, dikush në administratën e bashkisë etj. Pra nuk ka asnjë mundësi shantazhi apo kërcënimi, sepse tashmë dëshmitarët e organit të akuzës nuk janë pjesë e Partia e Lirisë që kryetari mund të ndikojë tek ata.



Në të tilla momente procedurale, sipas GJEDNJ, arresti në burg nuk duhet të vazhdojë, vlerësimi duhet të jetë individual dhe i motivuar mirë. Heqja ose zëvendësimi i kësaj mase bëhet kur:

1. Nuk ekziston më një nga arsyet ligjore për mbajtjen në paraburgim

Këto arsye janë:

- Rreziku i arratisjes
- Rreziku i pengimit të hetimeve
- Rreziku i përsëritjes së veprës penale
- Rreziku për rendin publik (në raste të veçanta)

Nëse këto arsye bijen, atëherë duhet që masat më të buta si arresti shtëpiak, detyrimi për paraqitje, apo garancia pasurore mund të jenë të mjaftueshme.

Sipas GJEDNJ, me kalimin e kohës, barrën për justifikimin e vazhdimit të arrestit me burg e ka gjithnjë e më shumë shteti.

Në çështjen **Buzadji v. Moldova**, GJEDNJ theksoi se: “Sa më shumë të zgjasë paraburgimi, aq më e fortë duhet të jetë justifikimi për mbajtjen në burg.”

Përfundimi i hetimeve është një ndryshim thelbësor procedural

Në momentin që hetimet janë përfunduar, sipas GJEDNJ, rreziku për ndikim në prova (sidomos në hetim) zvogëlohet ndjeshëm, për të mos thënë zhduket.

Në çështjen **Letellier v. France (1991)**, Gjykata tha:

“Rreziku për ndërhyrje në administrimin e drejtësisë nuk mund të justifikojë zgjatjen e paraburgimit për një periudhë të gjatë pas përfundimit të hetimeve”

Pra, argumenti që personi mund të “shantazhojë dëshmitarët” pas mbylljes së hetimeve është shumë i dobët, përveç nëse: Ka prova të reja dhe të qarta që i pandehuri ka tentuar ose ka shantazhuar dëshmitarë, dhe se kjo rrezikon seriozisht procesin penal në fazën e gjykimit.

Gjykata ka detyrimin të shqyrtojë masa më të buta.

Sipas GJEDNJ, në çdo vendim për zgjatjen e arrestit, gjykata duhet të analizojë seriozisht masat më të buta, si:

- detyrim paraqitjeje
- ndalim i kontaktit me dëshmitarët
- arrest shtëpie
- garanci pasurore
- masa të kombinuara

Në **Buzadji v. Moldova**, GJEDNJ tha:

“Gjykatat kombëtare nuk mund të mjaftohen me arsyetime standarde, por duhet të analizojnë seriozisht masat më pak kufizuese të lirisë.”



Në rastin konkret Gjykata Shkallës Parë nuk ka shqyrtuar alternativa të tjera dhe është mbështetur vetëm në një rrezik të supozuar, ku në këtë rast kemi një shkelje të mundshme të neni 5/3 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

A është e ligjshme mbajtja ende në paraburgim e ish Presidentit z. Ilir Metaj në këto kushte?

NGA KËNDVËSHTRIMI YNË NUK ËSHTË E LIGJSHME, për këto arsye:

1. Kalimi i kohës (11 muaj) e bën të domosdoshëm justifikimin me rrethana të forta dhe të reja.
2. Përfundimi i hetimeve heq shumicën e rrezikut për prishje provash ose ndikim në hetim.
3. Gjykata nuk ka dhënë arsyetim të individualizuar, dhe ka dështuar të analizojë masa më të buta.

Presidenti Partisë Lirisë dhe ish-presidenti Republikës deri tre vite më parë, i akuzuar dhe marrë i pandehur për vepra penale që pretendohet se kanë ndodhur në një kohë të largët dhe që organi akuzës ka përfunduar “punë” me të nga ana procedurale, është jopropocionale me qëndrimin e tij akoma në kushtet e paraburgimit.

Por kjo procedurë e ndjekur ndaj tij, ndoshta e paprecedentë në analet e drejtësisë Evropiane dhe vendeve demokratike, nga gjykata duke izoluar për 10 muaj për llogari të organit akuzës me pretendimin se do të mbledhi prova “rrugës”, është mënyra dhe forma më inkuizitore dhe persekucioni juridik në emër të “luftës kundër korrupsionit”. Historia ka vërtetuar katërcipërisht se këto mënyra aspak humane i ka flakur në koshin e plehrave të saj me gjithë sistemet më famëkeqe që i praktikuan ato njerëzimit..


Në kushtet e reja të krijuara pas përfundimit të hetimeve, dhe kalimin e çështjes në një fazë të re procedurale në gjykimin paraprak, si dhe duke u nisur edhe nga fakti që paraburgimi gjatë prej 10 muajsh është një formë paragyjimi dhe persekutimi, duke zhdukur edhe institucionin e prezumimit të pafajësisë, nuk është një qasje e një gjykatë të shtetit të së drejtës por qasje e një persekucioni politik.

Vendimi Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, (rasti Gëllçi kundër Shqipërisë), është një këmbanë alarmi që duhet të dëgjohet nga drejtësia shqiptare dhe të reflektohet mbi abuzimet e masave të sigurimit, veçanrisht atyre që janë të shtrira në kohë.

GJEDNJ konstatoi se, ka pasur shkelje të nenit 5/3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: paraburgimi prej mbi 7 muajsh nuk ishte i justifikuar mbështetur në prova konkrete, nuk u rishqyrtua siç duhet dhe nuk u konsideruan masa alternative të sigurimit.

Mungesa e shqyrtimit të masave alternative: Nuk u konsideruan masa më të lehta sigurimi si ndalimi në shtëpi, mbikëqyrje apo detyrimi për paraqitje periodike, pavarësisht kërkesave të shumta nga kërkuesi.

Kërkuesi ish Presidenti Ilir Metaj është në kushtet e njëjta procedurale, ka 10 muaj në paraburgim, është kërkuar zvendësimi masës sigurimit me masa të tjera që parashikon



dispozita e Kodit Procedurës Penale, dhe nuk janë marrë parasysh duke justifikuar nga gjykata me analiza juridike që nuk përputhen aspak me standaretet e parashikuara si nga ligji procedural penal, Kushtetuta dhe Konventa Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Në çështjen e kërkesit z. Ilir Metaj, ka edhe një element tjetër që gjykata nuk e ka marrë parasysh dhe siç duket me dashje e ka anashkaluar; Fakti që është edhe politikan aktiv, Presidenti Partisë Lirisë, dhe opozitës në Shqipëri.

Në kushtet e krijuara dhe përsa cituam më sipër, i kërkojmë Gjykatës së Posaçme të Apelit ndryshimin e vendimit nr. 546 datë 13.08.2025 të Gjykatës Shkallës Parë kundër Korrupsionit dhe Krimet Organizuar, dhe pranimin e kërkesës për zvendësimin e masës sigurimit personal për të pandehurin Ilir Metaj në një masë tjetër që të jetë propocionale me rrethanat e krijuara, por edhe me personalitetin e tij. Për ne masat më të përshtatshme janë: Ndalimit të daljes jashtë shtetit, Paraqitaja përpara oficerit policisë gjyqësore, dhe Garancia pasurore.

Përfaqësuesi ligjor
Studio ligjore "CAKRANI"
Av. Kujtim CAKRANI
Av. Dylejman KARAJ

I akuzuari
Ilir METAJ